



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 1036 Prot.

Tiranë, më. 22. 08.2023

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, dhe Vendimit Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funkcionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhërit të Kryeministrit, nr. 137, datë 21.10.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”. të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore shpall konkursin për pozicionin:

**SPECIALIST NË SEKTORIN E MONITORIMIT TË VEPRIMTARISË
ARKEOLOGJIKE NËNTOKSORE DHE NËNUJORE,
DREJTORIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK NË IKTK
kategoria e pages IV-3**

1. KUSHTET PËR KONKURIM DHE KRITERET E VEÇANTA:

1.1 Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas këtij ligji.

1.2 Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Duhet të ketë arsimin e lartë me diplomë të Nivelit të Dytë të njohur nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, në degën Histori/Arkeologji. Të zotërojnë diplomë të nivelit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

- "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë në degën Arkeologji .
- b) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse të diplomimit, të vërtetuar me librezë pune/vërtetim nga punëdhënësi.
 - c) Të ketë përvojë pune në fushën e arkeologjisë të shpëtimit jo më pak se 3 vjet, në procese si vëzhgim arkeologjik, sondazh/gërmim arkeologjik si dhe studime pas universitare/ kurse/ trajnime të shoqëruara me certifikatë ose diplomë përkatëse.
 - d) Të ketë aftësi për tu përshtatur me kushtet, teknologjinë dhe procedurat e reja të standarteve evropiane.
 - e) Të zotërojë gjuhën angleze. Të ketë njohuri në gjuhë të tjera përbën avantazh.
 - f) Të ketë aftësi praktike të të punuarit në kompjuter, në programe dhe softë: Paketa Microsoft Window (Word, Exel, Power Point, etj), etj. Njohja e programeve të tjera si ArcGIS, Adobe Illustrator, përbën avantazh.
 - g) Të ketë aftësi të mira për: përshtatje pune në grup; të ketë aftësi të përmbushë detyrat brenda afateve të përcaktuara; aftësi komunikimi, referimi dhe mbrojtje të të dhënave, analizave, vendimeve, monitorimit dhe raportimit.

2. PËRSHKRIM PUNE “SPECIALIST NË SEKTORIN E MONITORIMIT TË VEPRIMTARISË ARKEOLOGJIKE NËNTOKSORE DHE NËNUJORE, DSHA:

- 1. Realizon punën e sektorit në përputhje me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore për trashëgiminë kulturore.
- 2. Në zbatim të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale dhe detytrave të ngarkuara nga përgjegjës, kryen proceset arkeologjike: "këqyrje", "mbikëqyrje arkeologjike" "verifikime në terren".
- 3. Kryen mbikëqyrjen e proceseve arkeologjike në terren të ecurisë së punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projekteve zhvillimorë, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale.
- 4. Në bashkëpunim me sektorët e tjerë ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë për mbikëqyrjen, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.
- 5. Mban dhe përpilon dokumentacionin gjatë mbikëqyrjes së proceseve arkeologjike, në përputhje me rregulloret e miratuara.
- 6. Ndjek gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimorë ose punimeve të tjera të çfarë do lloji në bashkëpunim me SSHANN.
- 7. Realizon mbikëqyrjen e subjekteve private të licencuara gjatë kryerjes së proceseve arkeologjike të shpëtimit në zbatim të vendimeve të KKTKM dhe përpilon dokumentacionin e terrenit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

3. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

- a) Jetëshkrim i aplikantit;
- b) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c) Fotokopje të noterizuar diplomës;
- d) Fotokopje të noterizuar të listës së notave;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- h) Çertifikata kualifikimi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në protokollin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, brenda datës 31.08.2023.

4. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit në datën **31.08.2023**, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kushtet për konkurim, dhe do të shpallë në faqen e internetit të saj, listën e kandidatëve të kualifikuar që vazhdojnë konkurimin, datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar, do të njoftohen me e-mail nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë tij për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit.

Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

5. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Kandidatët e kualifikuar për vazhdimin e konkurimit, do të vlerësohen për:

- Njohuritë mbi:

- a) Ligji nr.76/2016, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tij;
- c) Vendimin Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funkcionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- d) Kodin e Procedurave Administrative;
- e) Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- f) Legjislacionin për Kodin e Punës dhe rregullat e etikës në administratën publike.

6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit: +355 699919396, ose në adresën: Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore: “Rr. “Aleksander Moisiu” nr.76, Ish-Kinostudio, Tiranë, SHQIPËRI”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

